



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN**  
**DREJTORATI I INSPEKTORATIT**



**DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

<b>Datë :</b>	<b>03.11.2024</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/11</b>
<b>Për :</b>	<b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Nga:</b>	<b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b>
<b>Lënda :</b>	<b>Raporti i muajit-nëntor</b>

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Gjatë muajit nëntor duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë, Drejtoria e Inspektoratit ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës.

Inspektorët e tregut- kanë inspektuar në vazhdimësi subjekte të ndryshme afariste për regjistrimin e bizneseve, pranimeve teknike, inspektime në markete me objektivë kontrollimi i çmimeve, vendosja e flamujve tregues të origjinës.

Sipas kërkesave të bizneseve janë bërë gjithsej dymbëdhjetë pranime teknike të bizneseve të cilat plotësojnë kushtet për të ushtruar aktivitetin e tyre biznesor.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësia në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” është zhvilluar një aksion i përbashkët lidhur me bizneset të cilat merren me dhënien e veturave me qera (renta car) secila parregullsi është trajtuar ligjërisht.

Gjithë ashtu në bizneset në të cilat kanë hasur parregullsi është iniciuar procedurë kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan.

Gjatë muajit nëntor është bërë inspektimi i tregjeve: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve.

Inspektori i mjedisit-ambientit- ka inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në disa fshatra, në Gadime e Ulët dhe e Epërme, Kodrën e Kërçevës, Janjevë, Gllogovc për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen apo gjeten dëshmi duke ndotë ambientit. Gjatë kontrollave në teren, janë hasur dy biznese duke ndez mbeturinat nga plastika, një biznes në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj me aktivitet prodhim i gypave të betonit dhe një biznes që merret me ndërtim në fshatin Rufc i Ri. Këtyre bizneseve iu është dhënë urdhëresë për fikjen e menjëhershme të zjarrit, si dhe nëse kjo vepër përsëritet do ndëshkohen me gjobë mandatore.

Janë inspektuar objektet ndërtimore me shumë njësi banimi dhe afarizëm të cilat janë duke u ndërtuar në Lipjan ku objektivë e inspektimit ka ishte zbatimi i kushteve të lejes mjedisore komunale, ku janë dhënë urdhëresa për grumbullim e mbeturinave dhe vendosja e tyre në kontejner si dhe lidhja e kontratës për mbeturina me K. Pastrimi. Ndaj dy investitorëve të objekteve ndërtimore për shkak të ndotjes me mbeturina u janë shqiptuar gjobë me aktvendim.

U jemi përgjigjur ankesave të pranuar nga qytetarëve si: në Janjevë ankesë për rrjedhje të ujërave të stallës në rrugë. Personit i është dhënë urdhëresë që të hapet një gropë në pronën e tij. për grumbullim të ujërave të stallës, e jo që ato të dalin në rrugë.

Po ashtu është bërë kontrollë tek një thertore në fshatin Banullë sipas ankesave në lidhje me mbeturinat e kafshëve të therura në pronën e ankuesit. Gjatë kontrollës nuk janë parë mbeturina në pronën e tjetrit (siç pretendohet nga ankuesi).

Inspektorët e trafikut- objektivë e inspektoreve të trafikut ishte veprimtaria e taksive ilegal dhe kombi taksi.

Janë realizu pika kontrolli për të përcjell rendet e udhëtimit nga kompanitë e ndryshme të autobusëve, ku janë urdhëruar që të respektojnë rendin e udhëtimit të lëshuar nga organi kompetent.

Janë bërë inspektime në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” me objektivë kontrolli i kompanive radio-taksi dhe taksiv ilegal të cilët merrnin pasagjer pa porosi që është në kundërshtim me Ligjin.

Inspektori i ndërtimit- gjatë këtij muaji inspektori i ndërtimit ka inspektuar në teren objektet të ndryshme ndërtimi përgjatë zonave urbane, ekonomike, industriale, si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët qofshin ato në mënyrë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit nëntor janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste, si dhe janë bërë pranime teknike të lokaleve afariste.

Janë inspektuar lokalet afariste, marketet ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet ne arkës gjatë pagesës.

Është bërë inspektimi i tregjeve, ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Inspektimi i auto-taksive në qytetin e Lipjanit.

Inspektimi i auto-taksi dhe kombi-taksi ilegal.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Gjoba mandatore	Njoftime për objektet e legalizuara nga DPUMM -ja	Vendosje të shiritave	Njoftime nga DPUMM	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Barazim i të hyrave nga pranimet teknike te lokaleve afariste	Lënd te ekzekutuara nga Gjykata	Të hyra nga pranimet teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektime për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	320	28	12	2						126	40			425.00€	10	11	51		36	4
Ambienti	24	7			2					6	5							4		
Ndërtimi	39	11				2		4		3	18						1			
Trafiku	76	20							26	15	2					12			1	
Gjithsej	459	66	12	2	2	2		4	26	150	65			425.00€	10	23	52	4	37	4

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.

